



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.36/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.B, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shpresa Musliu, për shkak të anulimit të vendimit nr. V_1023_2018 të datës 20.08.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 19.09.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 28.09.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., (KES/CO), me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. V_1023_2018 të datës 20.08.2018 të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KES/CO), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) nr. V_1023_2018 të datës 20.08.2018 si jo i ligjshëm, duke theksuar se korigjimi i datës 06.10.2016 është në përputhje të plotë me rregullat në fuqi, pasi që energjia e harxhuar nga konsumatori nuk është regjistruar e tëra në njehsorin elektrik. Tutje ka shtuar se korigjimi i cili është bërë nga ana e paditësit për konsumatorin A.M.H është në përputhje të plotë me rregullat në fuqi dhe i njëjti është bërë bazuar në gjendjen faktike ku është vërtetuar se njehsori nuk ka matur energjinë elektrike në masën prej 66% por vetëm 33% si rrjedhojë paditësi ka bërë korigjimin e faturave për konsumatorin në fjalë ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se fakti se njehsori elektrik nuk ka regjistruar në tërësi energjinë e shpenzuar është konstatuar edhe nga kontrolli i njehsorit në qendrën e kalibrimit dhe gjatë

inspektimit të dy sistemeve matëse, andaj, gjykatës i ka propozuar që të aprovet padia e paditësit KES/CO ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurës ZRRE si i pabazuar.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se pas analizimit të procesverbalit të inspektimit dhe të ndërrimit të njehsorit elektrik ka gjetur se në procesverbalin e inspektimit është konstatuar se njehsori është në rregull, dhe më pas është theksuar se është i manipuluar pasi që nuk bënë matje të fazës L2 dhe L3 ndërsa në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik është theksuar se njehsori elektrik duhet të shkoj për verifikim në qendrën e kalibrimit, pra kemi dy procesverbale në të cilat ekzistojnë paqartësi. Gjithashtu ka theksuar se pas analizimit që i është bërë shpenzimit të energjisë elektrike të konsumatorit respektivisht krahasimit të shpenzimeve në periudha të caktuara ka gjetur se nuk ka mospërputhje të shpenzimeve të energjisë elektrike. Ka theksuar se ZRRE nuk ka mundur të konstatoj se njësori i vjetër nuk ka bërë matje të saktë për periudhat me të cilat ngarkohet me korrigjim prej 66.66% pasi që ky korrigjim nuk reflekton gjendjen reale të shpenzimit të konsumatorit ngase po që se njehsori nuk do të kishte matur dy faza atëherë ai shpenzim do të duhej të reflektonte në shpenzimin të energjisë pas ndërrimit të njehsorit, por që edhe pas ndërrimit të njehsorit shpenzimet kanë qenë pothuajse të njëjta. Në seancën e shqyrtimit kryesor kanë theksuar se në rast se paditësi pretendon se konsumatori ka bërë ndërhyrje në njehsorin elektrik, atëherë në këtë rast kemi të bëjmë me vepër penale dhe se paditësi ka bërë kalkulimin e shpenzimeve të energjisë elektrike për periudhën kontestuese duke u bazuar vetëm në raportin e qendrës së kalibrimit, gjë që është në kundërshtim me nenin 8 par.3 të Procedurës për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, prandaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i bordit të ZRRE.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim i ZRRE nr. 1023/18 i datës 20.08.2018, Vendim i ZRRE nr.1824_07/18 i datës 09.07.2018, transaksionet e konsumatorit për periudhën 11.2005 - 08.2018, procesverbal nr.16/11 i datës 11.08.2016, Rrjedha e Njehsorit të Energjisë aktive për konsumatorin A.H, procesverbal nr. 589926 i datës 05.05.2016, procesverbal nr. 1972165 i datës 05.05.2016, kundërshtim nga KESCO i datës 30.07.2018, vendim i KESCO i datës 29.12.2016, formular i ankesës se konsumatorit i datës 08.11.2016, faturat e konsumatorit A.H për periudhën 11.2005 - 06.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Me Vendimin e Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK-së) ZRRE/DMK_V_1824_07/18 të datës 09.07.2018, është aprovuar ankesa e konsumatorit A.H, dhe është obliguar KES/CO që konsumatorit me shifër DPR-90040466, t'ia anulojë korrigjimin plotësues nr. 872954 DPR 90040466-90040466 të datës 06.10.2016 në vlerë prej 503.167€.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin, ka ushtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, të cilët me Vendimin V_1023_2018 të datës 20.08.2018 kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e KES/CO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin A.H, me shifër të konsumatorit DPR-90040466 dhe ka mbetur në fuqi vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_1824_07_18 i datës 09.07.2018.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 15 par. 1, nën-par. 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë të cilët përcaktojnë: *“1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: ... 1.8. të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licencuarve me rregulla adekuate për zgjidhje të kontesteve; 1.9. të sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë;”* si dhe në kuptim të nenit 17 par. 1 që përcakton se: *“1. Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat: 1.1. nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara;”*. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 14, 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë (Rregulla ZRRE/Nr. 04/2017 e datës 16 mars 2017) që përcaktojnë kompetencën e DMK-së pranë ZRRE për trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj vendimeve që merren nga furnizuesi apo operatori i sistemit si dhe kompetencën e Bordit të ZRRE-së për vendosjen për ankesat ose kontestet ndaj vendimeve të DMK-së.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara.

Gjykata nga prova Formular i ankesës së konsumatorit i datës 08.11.2016, ka konstatuar se konsumatori A.H me datë 08.11.2016 ka paraqitur tek paditësi ankesë për korrigjimin e bërë në vlerë prej 503.16€.

Nga prova procesverbal nr. 1972165 i datës 05.05.2016, gjykata ka konstatuar se paditësi tek konsumatori ka bërë shiqimin e njehsorit elektrik dhe ka konstatuar se njehsori elektrik është i pllombuar dhe në gjendje të rregullt dhe po ashtu ka konstatuar se është i manipuluar ku nuk matë L3 dhe L3.

Nga prova procesverbal nr. 589926 i datës 05.05.2016 gjykata ka konstatuar se konsumatorit me datë 05.05.2016 i është bërë ndërrimi dhe heqja e njehsorit elektrik.

Nga prova procesverbal nr.16/11 i datës 11.08.2016, gjykata ka konstatuar se nga kontrollimi i njehsorit të bërë nga Qendra e Kalibrimit ka rezultuar se njehsori elektrik pllombat i ka në rregull, nga ana e jashtme nuk ka dëmtime, ndërsa në brendi te njehsorit komisioni ka vërejtur se sistemet e fazave S dhe T janë të djegura dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrik për 66.66% më pak.

Nga prova Rrjedha e njehsorit të energjisë aktive dhe Transaksionet e konsumatorit gjykata konstatoi se konsumatori ka pasur shpenzime të përafërta para ndërrimit të njehsorit elektrik me datën 05.05.2016 dhe pas ndërrimit të njehsorit elektrik, kjo pasi që nga krahasimi i shpenzimeve përgjatë viteve të ndryshme rezulton se konsumatori gjatë vitit 2014 ka shpenzuar mesatarisht 477 kWh në muaj, gjatë vitit 2016 ka shpenzuar mesatarisht 541 kWh në muaj, gjatë vitit 2016 ka shpenzuar mesatarisht 605 kWh në muaj, gjatë vitit 2017 ka shpenzuar mesatarisht 403 kWh në muaj dhe gjatë vitit 2018 ka shpenzuar mesatarisht 381 kWh në muaj. Nga kjo rezulton se konsumatori pas ndërrimit të njehsorit elektrik ka shpenzuar më pak se vitet paraprake kur paditësi pretendon se njehsori ka regjistruar energji elektrike për 66.66% më pak.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me konstatimin e DMK-së se korrigjimi shtesë i faturuar nga KES/CO për periudhën nëntor 2015 deri me prill 2016 nuk ka qenë i saktë, pasi që nga krahasimi i shpenzimeve me vitet paraprake dhe vitet pas ndërrimit të njehsorit, tek konsumatori nuk është vërejtur ndonjë ndryshim në konsumimin e energjisë elektrike, madje pas ndërrimit të njehsorit, konsumatori ka shpenzime më pak energji elektrike, andaj korrigjimi shtesë prej 66.66% nuk mund të jetë i saktë sepse në të kundërtën konsumatori do të kishte rritje te shpenzimit të energjisë elektrike me njehsorin e ri.

Gjykata vlerëson se një faturim i tillë nga paditësi është në kundërshtim me nenin 29 në par. 1 të Ligjit Nr. 04/L-121 për Mbrojtjen e Konsumatorit i cili përcakton se: *“1. Faturimi i energjisë dhe i ujit llogaritet në bazë të konsumit real të lexuar në njehsorin e konsumatorit.* Gjithashtu gjykata vlerëson se korrigjimi i bërë nga paditësi është në kundërshtim edhe me Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji (Rregulla ZRRE/Nr. 12/2017, 13 prill 2017) në nenin 5 par. 1, pika 1.5 që përcakton se: *“1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të: 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja;”* dhe në pikën 1.6. përcakton se: *“marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me energji të cilësisë së dobët dhe shërbim, që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.”*

Gjithashtu në nenin 28 par. 1 dhe 3 përcaktohet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjetër, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). ... 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.”*

Gjykata vlerëson se ZRRE ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit kundër Vendimit të DMK-së me të cilin është vendosur që të anulohet korrigjimi plotësues nr. 87294DPR-90040466-90040466 i datës 06.10.2016 në vlerë prej 503.16€.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditësit të dhëna në padi dhe në seancën gjyqësore se konsumatori ka manipuluar njehsorin elektrik, por të njëjtat pretendime i vlerësoi si të pabazuara për shkak se në rastet e manipulimit të njehsorit duhet të iniciohet procedurë penale ndaj konsumatorit, ndërsa në këtë çështje nuk është dorëzuar ndonjë provë për të mbështetur një pretendim të tillë.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.36/22, datë 28.09.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.